

GJASIMET E KRYEPERSONAZHIT TË ROMANIT „PSE“ TË STERJO SPASSES ME LETËRSINË FRANCEZE

Shpresa MEMEDI¹

¹ *Institute of Spiritual and Cultural Heritage of the Albanians - Skopje*

**Corresponding author e-mail: shpresamemedi@hotmail.com*

Përmbledhje

Në këtë studim shkencor do të përpiqem ti zë pikat puthitëse në mes romanit „Pse” të Sterjo Spasses dhe kryepersonazhit të tij, me letërsinë franceze. Në korpusin letrar të letërsisë franceze do të prezantohen disa shkrimtar të gjysmës së dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, sepse krijimtaria e tyre letrare në përmbajtje është plot pikëllim të pafund për çështjet e jetës në përgjithësi, lindjen e nostalgjisë, ikjen nga vetvetja, obsesionin me pavlefshmërinë e jetës, deri në pesimizëm dhe nihilizëm total. Pothuajse të gjitha këto gjendje shpirtërore janë të pranishme në romanin “Pse” të S. Spasses, por duke pasur parasysh gjithmonë kushtet e tjera ekonomike, politike dhe sociale.

Chateaubriand, Alfred De Vigny, Sainte Beuve, Alfred De Musset dhe ndoshta një nga poetët më të mëdhenj të shpirtit pesimist në veprën e tij, është i madhi *Charles Baudelaire*, i cili në shumë raste përkon me admirimin pesimist të të gjitha vlerave jetësore, dhe çrregullimeve mendore me atë të personazhit kryesor, Gjon Zaveri. Në prezantimin e mëtejshëm në pjesën kryesore do të analizohen veprat letrare të këtyre shkrimtarëve të mëdhenj, me qëllim që të tregohen pikat afërsisht të përbashkëta që lidhin personazhin kryesor Gjon Zaveri, me pavlefshmërinë e jetës dhe mungesën e vetëbesimit, tema fillestare të preferuara, që zbukuronin veprat letrare të shkrimtarëve të lartpërmendur, në gjysmën e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë.

Fjalët çelës: *Romani „Pse”, Alfred De Vigny, Sainte Beuve, Alfred De Musset, Charles Baudelaire, Chateaubriand.*

Sueta e qeveris botën, por ti o njeri, sërish e bën marrëzinë tënde. Një shkrimtar thotë: dashuria dhe vetëm dashuria është jeta. Tani, unë, Gjon Zaveri, them: ”Suetë, vetëm suetë është jeta!” (Pse, fq.86)

Është kjo një gjendje shpirtërore që e karakterizon personazhin kryesor, Gjon Zaveri në romanin „Pse” të Sterjo Spasses. Personaliteti i Gjonit në këtë vepër kurorëzohet edhe me një dozë të antihedonizmit dhe ekletizmit në veprime. Nuk është aspak stoik sepse shpirti i tij është mbështjellë me një skepticizëm të veçantë. Ky lloj skepticizmi, këto gjendje pesimiste dhe nihiliste janë substrati kryesor edhe në veprat e shkrimtarëve të lartpërmendur të letërsisë franceze.

Shekulli i nëntëmbëdhjetë, veçanërisht vitet që gravitojnë në gjysmën e dytë të të njëjtit shekull, është një epokë polemikash dhe mosmarrëveshjes për të cilën letrarët aludojnë për një zgjidhje harmonike dhe të mirë të këtyre dukurive devijuese. Pra, këto antiteza apo kundërvënie që lindën nga një ankth i madh, dhe njëkohësisht ushqeheshin nga frika alarmante e dëshirës së lartë për të paarrtshmen, rezultuan në lindjen e “Krimbit” të parë të romantizmit, me arratisje nostalgjike nga realiteti duke jetuar nën kujtimet e rreme të së kaluarës.

Ky frymëzim i ekzagjeruar romantik, pasion dhe pikëllim i pafund për çështjet e jetës, përqsja e shëndoshë ndaj fenomeneve në përgjithësi dhe veçanërisht ndaj atyre natyrore që na rrethojnë, afirmimi i dukurive të harlisura në natyrë, çojnë në rrezik dhe pesimizëm. Kështu lind nostalgjia, ikja nga vetvetja, individualizmi, obsesioni pas pavlefshmërisë së jetës, mungesa e vetëbesimit, izolimi në vetvete dhe në fund mohimi i të gjitha vlerave jetësore, domethënë nihilizmi.

Në romanin „Pse” në faqen 19, Gjon Zaveri thotë: „*O! Vetmi-gëzimi im, jetë për mua. Në ty gjej paqen e shpirtit tim të shqetësuar, në ty është zemra ime...nga ty dalin mendimet e mia të pastra! Nuk do të doja që asgjë ta thyente heshtjen paqësore...Vetminë.Kështu dua të ec kjo botë.Kështu dua t'ia lë përshëndetjen e fundit kësaj bote të rreme....kështu dua ta dorëzojë shpirtin tim*”

Chateaubriand¹⁵⁸ - (1768 – 1848) Shkrimtari francez në novelën e tij “Renee”¹⁵⁹ përshkruan shumë bukur gjendjen e tij shpirtërore, në lidhje me këtë situatë ai rrëfen trishtimin në brendinë e tij me këto fjalë, gjatë një udhëtimit në natyrë :

“Si të tregohet kjo tufë ndjesish që zien në shpirtin dhe unë i ndjej gjatë shëtitjeve të mia? Zhurmat që ndryshojnë ndjenjat e një zbrazëtie në zemrën e vetmuar që duken si pëshpëritje dhe erërat fryjnë heshtjen e përjetshme të një shkretimi të pafund: nuk mund të shijohen, as të pasqyrohen...”

“Kënga e natyrshme e Njeriut është trishtuese” (Renee, fq. 1)

Janë këto disa gjendje të dhimbjes, që identifikohen plotësisht me personalitetin e Gjon Zaverit dhe vizionin e tij, mohimet dhe të menduarit mbi botën. Në këtë drejtim, gjithashtu i paluhatur, me qëndrueshmëri të fortë, gjigant në shkrimet e tij duke mos u larguar nga rruga e paramenduar, është poeti i madh i lirikës Franceze La Martini ¹⁶⁰(1790-1869) kur thotë:

„Pavdekësia, Asgjëja, Koha e kaluar, Humnera e errët

Çfarë bëni me ditët që gëlltisni?”(La Martine, Liqeni, vargu12)

Gjendje shpirtërore që i karakterizojnë personalitetet e këtyre shkrimtarëve, të cilët gjasojnë në disa pika me personalitetin e kryepersonazhit Gjon Zaveri në romanin „Pse” të Sterjo Spasses. Në vazhdim të studimit shkencor janë edhe disa shembuj të lirikëve të famshëm francez Alfred de Vigny, Sainte Beuve dhe Alfred de Musset ku fryma e pesimizmit dhe nihilizmit paraqesin një trajtë identike me mendimet e kryepersonazhit në romanin „Pse”.

¹⁵⁸ François-Rene de Chateaubriand ka qenë një ndër përfaqësuesit më të spikatur të reaksionit kundër ideve të Revolucionit Frances si dhe figura më e shquar e letërsisë frënge në periudhën e Perandorisë së Parë.Këtë shkrimtarë e interesojnë tri tema të mëdha: politika, religjioni dhe ndjenjat romantike.

¹⁵⁹ Novela „Rene” është e botuar në vitin 1802.Rene rrëfen për një person me emocione të forta tejet i ndjeshëm i cili ka përjetime të çuditshme në shoqërinë bashkëkohore.

¹⁶⁰Alphonse de Lamartine është një poet, romancier, dramaturg francez, si dhe një personalitet politik që mori pjesë në Revolucionin e shkurtit.Ai është një nga figurat e shkëlqyera të romantizmit në Francë.

Alfred de Vigny¹⁶¹ në poezinë e tij “*Shtëpia e Bariut*” në fund thotë:

*“Ne shkojmë kështu, duke lënë vetëm hijen tonë,
Nëpër këtë tokë të mjerë ku kanë kaluar dhe të vdekurit,
Ne do të flasim për to në
Koha kur mbretëron errësira,
Ose kur ju pëlqen të ndiqni një rrugë të fshirë ”
Ose në të njëjtën këngë kur thotë:
“Unë e dëshiroj madhësinë e vuajtjes njerëzore”*

Charles Augustin de Sainte Beuve¹⁶²(1804-1869) Njëri ndër poetët më të veçantë të letërsisë frenge, në këtë mënyrë shpreh pakënaqësinë e tij për jetën, me gjuhën e një gruaje:

“Ajo foli vetëm për të këqijat e botës dhe për një jetë të hidhur”.
Dhe më poshtë:
*“Dhe duke mos dashur ah! I dorëzohem frikës
Duke menduar ditët që kaluan kaq shpejt për mua ”...*

Alfred de Musset¹⁶³(1810-1857) është një poet tjetër në listën e viganëve të letërsisë frenge, në poezinë e tij „*Kënga*” e sheh botën dhe pakënaqësinë për të në këtë mënyrë :

*“I thashë zemrës sime, zemrës sime të dobët
Nuk ju mjafton gjithë kjo frikë
A nuk e shihni këtë në çdo ndryshim të vazhdueshëm
Ju pret një trishtim, një hap me një makth të tejmbushur?”*

*Ai mu përgjigj: nuk mjafton akoma
E gjithë kjo telashe nuk mjafton ende
A nuk e shihni se ky ndryshim i vazhdueshëm?
Na bën të ndihemi mirë dhe të ëmbël në të kaluarën ”*

Në poezinë “*Pelikani*”, në disa vargje të saj, poeti i madh pakënaqësinë dhe oscilimet e shpirtit pesimist i shpreh në këtë mënyrë :

*“Kur ata folën për shpresën e humbur si kjo,
Për pikëllimin dhe harresën, për dashurinë dhe fatkeqësinë,
Ata nuk argëtojnë për të zgjuar zemrën
“Sepse recitimet e tyre gjasojnë si shpata të hidhura të mprehta.”*

Kur flasim për pesimizmin dhe nihilizmin e kryepersonazhit Gjon Zaveri në romanin „Pse” krahasuar me poet të letërsisë franceze, nuk do të kalojmë më tej, duke e lënë në harresë edhe një poet të madh, ndoshta ndër më të mëdhenjtë për sa i përket shpirtit pesimist dhe nihilist në veprat e tij.

¹⁶¹ Alfred Victor, Comte de Vigny ishte poet Francez dhe lider i hershëm i Romantizmit Francez

¹⁶² Charles Augustin de Sainte Beuve- Kritik francez dhe eseist. Në kontinuitet boton kritikë letrare dhe ese në gazetë më prestigjioze të kohës së vet. Prej vitit 1844 është anëtarë i Akademisë Franceze. Në vitin 1855 ka qenë i zgjedhur profesor i Gjuhës Latine në College de France.

¹⁶³ Alfred de Musset- Poet Francez, dramaturg, romancier i kohës së romantizmit. I interesuar për medicinën dhe drejtësinë por së shpejti heq dorë nga studimet që ti përkushtohet përfundimisht letërsisë. Viziton qarkun letrar të Sharl Nodje, dhe në moshën 19 vjeçare boton përmbledhjen e pare poetike me titull, „Rrëfimet nga Spanja dhe Italia.

Është Charles Baudelaire me veprën e tij „Shpretka” (Shpretka dhe Ideali), i cili drejton njëherit dhe veprën e tij kryesore, “*Lulet e së Keqes*”. Shpretkë - që në gjuhën angleze do të thotë zhgënjim emocional i pafund, ai e përdori këtë fjalë për të tingëlluar më mirë dhe për të pasur një shtjellim të plotë të ndjenjave të tij të brendshme.

Charles Baudelaire¹⁶⁴ (1821-1867) është pasardhësi i melankolisë së errët të Chateaubriand-it dhe anglezit të madh George Gordon Bajron¹⁶⁵. Një bashkëkohës i filozofisë dekurajuese të poetit francez Alfred de Vigne ndaj nihilizmit të Gustav Floberit (me romanin e famshëm „Zonja Bovary” ku kryepersonazhi i romanit jep fund jetës së pavlerë duke pirë helm). Baudelaire është thellësisht i bindur në shpirtin dhe mendjen e tij se bota është e keqe dhe për këtë ai arrin të gjejë në korpusin e tij letrar fakte konkrete për këtë fatkeqësi që mbizotëron mbi gjithë botën dhe njerëzit në përgjithësi.

Baudelaire e konsideron veten një burrë të lindur me fat të keq. Fatkeqësia e tij është e lidhur ngushtë me një pesimizëm të errët që kërkon me një nostalgji të paparë, të gjejë lumturinë e humbur përgjithmonë. Këtë disfatë ai mundohet ta gjejë me forcë, duke i imponuar vetes një harmoni mendore dhe ekuilibër konfuz. Udhëtimet e gjata që bënte, herë pas herë mendonte se do t’i sjellin baraspeshën shpirtërore, por gjithnjë përfundon me iluzionet e tij të pashpresë.

Të gjitha këto përpjekje përfunduan pa sukses, mbetën të kota, sepse udhëtimet e gjata nuk ishin gjë tjetër veçse një përpjekje fatale për të shpëtuar nga mizoria e jetës së shqetësuar. Në këmbim ai mendon se trupi, me mëkatet që bën, është shkaku i të gjitha të këqijave. Ai arrin në përfundim, se vdekja është i vetmi fenomen natyror që e çliron plotësisht njeriun. Për të konfirmuar këtë gjë, japim një shembull të pesimizmit Bodlerian:

“Qofshit të bekuar O PERËNDI, që na dhuroni vuajtjen”.

Si një ilaç hyjnor kundër çoroditjeve tona ”

Pages Choisies, në Paris, 1937, në botimin e Hachette

Në një poezi tjetër me titull “*Gjakftohtësia*” këshillon vuajtjet shpirtërore në këtë mënyrë :

“Qetësohu dhimbja ime dhe ndalo veten

Ju po e kërkon atë sonte, ja ku ajo vjen

Një faqe e errët mbulon qytetin

Për disa, duke sjellë heshtje të dashur,

Për të tjerët kujdesi i dëshiruar ”nga poezia” Benedikti "ose" Bekimi”

Kjo është faza fillestare në të cilën poeti qëndron në një udhëkryq nga i cili kërkon një dalje në paqen shpirtërore, në jetën normale. Por krimbi i zhgënjimit emocional nuk e lë të qetë, ku shkruan pak më vonë:

“Unë e di se kujdesi është bujaria e vetme.”

Të gjitha këto gjendje shpirtërore, pesimiste dhe nihiliste janë të pranishme në romanin “Pse” të Sterjo Spases por në kushte të tjera ekonomike, politike dhe sociale. Shkrimtari Sterjo Spasse mund të mos ketë lexuar “*Lulet e së Keqes*” dhe „*Idealin*” e „*Charles Baudelaire*”, por të gjitha mundësitë datojnë nga pakënaqësia pesimiste dhe nihiliste e të gjitha vlerave jetësore.

¹⁶⁴ Charles Baudelaire ka qenë poet më i njohur francez si dhe themelues i Modernizmit. Është takuar me Balzakun dhe në atë periudhë kohore ka shkruar shumë poezi të cilët poezi janë bërë pjesë e ciklit më të njohur poetik të tij, „*Lulet e së keqes*”. Ka qenë i njohur si kritik pasionant i letërsisë dhe në këtë mënyrë ka tërhequr vëmendje të madhe nga qarqet e famshme letrare të kohës së atëhershme.

¹⁶⁵ George Gordon Bayron shkrimtar anglez i romantizmit

Mohimi dhe kundërvlera, çrregullimet mendore të *Gjon Zaverit* shpesh përkojnë me ato të *Sharl Bodlerit* dhe të disa shkrimtarëve të mëdhenj perëndimorë “*Dekadent*” të gjysmës së dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Duke filluar me filozofinë e novelës “*Renee*” të *Chateaubriand-it* dhe shkrimtarët francezë siç janë: *La Martin*, *Alfred de Vigny*, *Alfred de Musset*, pesimizmi i *Gustav Flaubert-it*, pesimizmi i anglezit *George Gordon Byron*, i shkrimtarit amerikan *Edgar Allan Poe*, veçanërisht nga poezia e tij „*The Raven*” ku në fund të çdo strofe përsëritet refreni “*Kurrë më*”.

Përfundim

Gjon Zaveri është një tip specifik në letërsinë shqipe, ndoshta i vetmi i kësaj kategorie. Si i tillë nuk është fort bindës, por duke u bazuar në kohën e zymtë letrare të Evropës Perëndimore dhe në rrethanat e errta shoqërore ekonomike dhe arsimore në vend, ndoshta kishte mundësi për ekzistimin e një personazhi të tillë, siç ishte dhe rasti me heroin *Merso* në romanin „*I Huaji*” të shkrimtarit të madh francez *Alber Kamy*, një personazh i cili mendon se „jeta është absurdi më i madh”. Pra Gjoni, duke i përzier të gjitha këto mendime nga pak, nuk arrin dot ta formojë qëndrimin e vet, por e preferon vetminë, e cila errësirë në fund shndërrohet në një mohim total i të gjitha vlerave që i ka krijuar njeriu me mundime dhe sakrifica të mëdha.

Referencat

- Bala Vebi dhe Kodra Klara, *Historia e Letërsisë Shqipe*, Prishtinë, Rilindja, 1988.
- Bodler *Sharl*, *Poezi të zgjedhura*, Paris: Larus, 1919.
- Lamartin, De Alfons. *Vetmia Poezi*. Beograd: 1954 (Përkthim nga Miodrag Tomić)
- Matvejeviç, Predrag. *Estetika moderne dhe Bodleri*. Sarajevë: 1954
- Petroviç, Lubomir. *Shqyrtim i Letërsisë Franceze*. Beograd Privrednik, 1929
- Spasse, Sterjo. „Pse” Prishtinë: Rilindja, 1986.